

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SH.P.K.) "ARTI"

Ne baze te ligjit 7512 date 10.8.1991 dhe ligjit 7636 date 19.11.92 ne, Arqile Papuci dhe Timoleo Kajo shtetas shqiptar me banim ne qytetin e Sarandes vendosem te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar sipas kushteve qe vijojnë :

N E N I 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ARTI" (SH.P.K.).

N E N I 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshtë :

- Veprimitari ne fushen e studimeve gjeologjike.
- Veprimitari projektimi dhe ndertimi ne fushen e ndertimeve.
- Prodhimin e materialeve te ndertimit si dhe tregetimin e tyre ne vend dhe import - eksportin e tyre.
- Veprimitari tregetimi te mallrave te ndryshme.

N E N I 3

Selia e shoqerise ndodhet ne Republiken e Shqiperise, ne qytetin e Sarandes ne adresen : Lagja 4.

N E N I 4

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar.

N E N I 5

Kapitali themeltar i shoqerise është i fiksuar ne shumën 100.000 lekë, i ndarë në 100 kuota me nga 1000 lekë sejcili.

N E N I 6

Kuotat e mëna nga ortakët në kapitalin themeltar janë të transferueshme midis te gjallëve me akt notarial, me kusht që ky transferim të jetë miratuar nga ortakët.

N E N I 7

Ortakët mund të vendosin për zgogelimin e kapitalit Themeltar të shoqërisë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kapitali themeltar është i depozituar në degën e Bankës se Shtetit shqiptar dhe është i nënëshkrueshëm nga ortakët.

N E N I 8

Shoqeria administrohet nga administratori Arqile Papuci, i cili ka kompetenca te plota per drejtimin dhe administrimin e shoqerise. Përfaqëson shoqerine ne lidhje me te tretët si dhe ne organet e drejtësisë. Gjithashtu ai ka të drejtë të ndermarrë veprime ne instancat administrative dhe gjyqesore. Arqike Papuci e pranon detyren e administratorit të shoqërisë.

N E N I 9

Punësimi i personave të tretë në shoqëri do të bëhet në bazë të kontratës individuale të punës dhe do të zbatohet legjislacioni Shqiptar i punës për të gjitha problemet që nuk parashikohen në kontratën individuale të punës.

N E N I 10

Viti finanziar mbylljet më 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbylljet financiare, administratorët ndjekin hartimin e llogarise vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore. Ortakët miratojnë bilancet në se shtë e nevojshme pas raportit të revizorëve të kontabilitetit, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

N E N I 11

Ortakët gëzojnë të drejtën për tēheqjen e fondeve të nevojshme të kapitalit themeltar, nga banka shqiptare, duke depozituuar firmën si firmë e parë pranë asaj banke.

N E N I 12

Shpenzimet e nevojshme deri në themelimin e shoqërisë janë në ngarkim të shoqërisë e cila me krijimin e saj merr përsipër këtë detyrim.

N E N I 13

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve brenda dhe jashtë shoqërisë, me persona fizikë e juridikë etj. zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga gjykata kompetente shqiptare.

N E N I 14

Përsa nuk është shprehur në këtë akt - themeli, shoqëria i referohet çdo ligji të veçantë përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

N E N I 15

Ky akt - themeli hartohet në tre kopje për t'u dorëzuar në organet kompetente. Një kopje e këtij akti mbetet pjesë e dokumentacionit të shoqërisë.

T H E M E L U E S I T

Timoleo Kajo

Argile Papuçı

Sarandë, më

✓ 3

Cape

S T A T U T I

I SHOQERTISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SH.P.K.) "ARTI"

Në bazë të ligjit 7512 datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit", si dhe ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", shtetasit shqiptar Argile Papuç i dhe Timoleo Kajo me banim në qytetin e Sarandës vendosën të ushtrojnë aktivitet privat me ortakëri, duke krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) me seli në Sarandë, në kushtet si vijon :

DISPOZITA THEMELORE

Forma, Emërtimi, Objekti, Selia, Kohëzgjatje

N E N I 1

F o r m a

Nga Argile Papuç i e Timoleo Kajo është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e këtij statuti.

N E N I 2

S e l i a

Selia e shoqerise është në Sarandë, në lagjen 4.

Shoqëria mund të zhvilloj meprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Transferimi i Selisë në një vend tjetër bëhet me miratim të ortakëve.

N E N I 3

O b j e k t i

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

- Veprimitari në fushën e studimeve gjeologjike.
- Veprimitari projektimi dhe ndërtimi në fushën e ndërtimeve.
- Prodhimin ematerialeve të ndërtimit dhe tregëtimin e tyre në vend dhe import - eksportin e tyre.
- Veprimitari tregëtimi të mallrave të ndryshme.

N E N I 4

E m ë r t i m i

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të emërtohet SH.P.K. "ARTI".

N E N I 5

K o h ë z g j a t j a

Shoqeria krijohet me kohezgjatje të pakufizuar.

Ajo mund të prihet ose të riorganizohet në çdo kohë me miratim të ortakëve.

N E N I 6

Shoqeria fiton personalitet juridik që nga dita e regjistrimit te saj në regjistrin tregëtar.

N E N I 7

K A P I T A L I I S H O Q E R I S E

Për fillimin e veprimtarisë ekonomiko - financiare, shoqëria disponon një kapital fillestar në vlerën 100.000 lekë.

N E N I 8

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet sipas rritjes së veprimtarisë ekonomike të saj. Fondet monetare do të sigurohen nëpërmjet veprimtarisë ekonomike të përcaktuar në nenin 3 të këtij statuti.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI, MARREDHENIET EKONOMIKE TE SHOQERISE

N E N I 9

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) me ortakëri do të ketë si administrator Arqile Papuçinë, drejtues teknik Timoleo Kajon të cilët kanë pushtet të plotë në administrimin e shoqërisë dhe kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet që i gjykojnë të arsyeshme për arritjen e objektivave të shoqërisë me përjashtim të atyre që i rezervor ligji.

N E N I 10

Shoqëria administrohet nga administratori Arqile Papuci dhe Timoleo Kajo të cilët vendosin :

- Miratimin e Statutit të shoqërisë.
- Miratimin e programit ekonomik të shoqërisë.
- Ndarjen dhe përdorimin e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Miratojnë llogaritë nëse është e nevojshme, pas raportit të ekspertot kontabël të miratuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar.
- Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e veta. Vendimet e tyre evidentohen në një regjistër të veçantë.
- Miratojnë shndrimin e shoqërisë.
- Vendosin për ndërprerjen e veprimtarise se shoqerise.
- Vendosin për marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë etj.

N E N I 11

Për sigurimin dhe funksionimin normal të shoqërisë(ajo) shoqëria mund të lidh kontrata me sektore te tjere shtetërore; drejtë për drejt me tregun e lirë, si dhe me persona fizik e juridik, vendas e të huaj sipas legjislacionit në fuqi për import - eksportin.

N E N I 12

Ne veprimet kontabel shoqeria perfaqesohet nga administratori Arqile Pa-puci dhe pergjegjesi teknik Timoleo Kajo ose persona te tje te autorizuar prej tyre.

N E N I 13

Ne baze te rregullave te percaktuara nga Ministria e Financave, shoqeria per gjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, sigurimet shoqerore etjera.

N E N I 14

Për pasqyrimin e aktivitetit te shoqerise, administratori i saj ose persona te tje te caktuar prej tij jane te detyruar te mbajne dokumentacionin e rregullt financiar dhe register perkates sipas ligjit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.

N E N I 15

Administratori i shoqerise dhe pergjegjesi teknik kane te drejte te çelin llogarine perkatese prane Bankave te vendit dhe te huaja ne Shqiperi dhe te kryejne veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

N E N I 16

Administratori i shoqerise dhe pergjegjesi teknik Jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor se bashku me deklaratën e te ardhurave, te humbjeve dhe fitimeve dhe t'i depozitojnë në organin financiar te juridiksionit që ushtron veprimtarinë shoqëria.

N E N I 17

Për ushtrimin e veprimtarisë se saj ekonomike, shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj.

N E N I 18

Shoqeria mund te marre kredi nga bankat e Shqiperise, ose bankat e huaja, shteterore ose private, vendase ose te huaja. Shkembimi i monedhes shqiptare me monedhe te huaj dhe anasjelltas, shoqeria mund ta bej ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose ne tregun e valutes(ne tregun e lire privat te valutes).

N E N I 19

Shoqeria ka te drejte te transferoj jashte shtetit shqiptar pjesen e saj te fitimit dhe kapitalin. Per aktivitetin administrativ shoqeria duhet te paiset me vulen e saj.

N E N I 20

Administratori i shoqerise dhe pergjegjesi teknik ose persona te tje te autorizuar prej tyre kane te drejte ta perfaqesojne ate ne organet gjyqesore etj.

M A R R E D H E N I E T E P U N E S I M I T

N E N I 21

Administratori i shoqerise dhe pergjegjesi teknik kane te drejte te percaktojne numurin e anetareve te shoqerise. Marredheniet e punesimit te shoqerise behen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Per

çështjet qe nuk parashikohen ne kontrate, zbatohen dispozitat e kodit te punes si dhe ligjet per marredheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

N E N I 22

Marrja ne punie behet me regjistrin e punonjesve, ne librin e punes si dhe duke njoftuar organet e punesimit te juridiksionit ku ushtron veprimtarine shoqeria. Te punesuarit brenda shoqerise jane te detyruar te respektojne disiplinen e punes, orarin etj., tëmbajne pergjegjesi per thyerjet e disiplines si **dhe** per demet qe i shkaktojne pasurise se shoqerise. Ndaj tyre zbatohen ligjet ne fuqi.

N E N I 23

Ndryshimi i vendit te punes brenda shoqerise behet me urdher me shkrim te administratorit te shoqerise dhe pergjegjesit teknik. Largimi pergjithmoqe i punonjesit nga shoqeria behet me urdher me shkrim te administratorit te shoqerise dhe pergjegjesit teknik mbasi te kete shlyer detyrimet detyrimet materiale e monetare.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

N E N I 24

Tëo ardhurat e veprimtarise private te shoqerise sigurohen sipas çmimeve qe i cakton vete shoqeria. Çmimet dhe tarifat do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

N E N I 25

Te ardhurat neto krijohen nga vecimi i fondit te akumulimit, shlyerjes se detyrimit fiskal, sigurimeve shoqerore etj.

SHPERBERJA E SHOQERISE

N E N I 26

Shoqeria mund te shperbehet ne çdo kohe kur veprimtaria e saj ekonomiko financiare falimenton. Me rastin e pushimit te veprimtarise se saj ekonomi ke behet likujdimi perfundimtar i, pasurise se shoqerise.

N E N I 27

Kur pushon veprimtaria e shoqerise, mbasi shlyhen detyrimet fiskale sigurimet shoqerore etj. kapitali i mbetur u kalon ne pronesi themeluesve te shoqerise Arqile Papuç i dhe Timoleo Kajo.

DISPOZITAT TE FUNDIT

N E N I 28

Mosmarreveshjet midis paleve brënda shoqerise dhe jashte saj, ne marrdhenie me persona fizike dhe juridike etj. zgjidhen ne mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

N E N I 29

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet çdo ligji te vecante perkates te Republikes te Shqiperise.

N E N I 30

Ky statut hartohet ne tre kopje per t'u dorezuar ne organet kompetente shqiptare. Një kopje e ketij mbetet pjese e dokumentacionit te shoqerise me seli ne qytetin e Sarandëz

T H E M E L U E S I T

Arqile Papuç

Timoleo Kajo